



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија  
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Data: 08 Nëntor 2019

## NJOFTIM

### Aktiviteti humanitar për dhurimin e gjakut “Zemra e Fondit”

Sot për të gjashtë herë me radhë, të punësuarit e Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut u solidarizuan me aktivitetin humanitar për dhurimin e gjakut “Zemra e Fondit”. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunimin me Institutin për mjekësi transfuzive dhe Kryqin e kuq.



Qëllimi i aktivitetit është t'a ngrejë vetëdijen e popullit për rëndësinë e sigurimit të gjakut në kohë, për të shpëtuar jetë njeriu dhe të shërbejë për t'i inkurajuar sa më shumë njerëzit që të dhurojnë gjak.

Aktiviteti humanitar për dhurimin e gjakut zhvillohet në qendrën e Fondit për sigurim shëndetësor të RMV-së respektivisht, të punësuarit e qendrës dhe të njësisë rajonale të Shkupit sot e dëshmojnë anën e tyre humane përmes dhurimit të gjakut.